

Mr. Rejhan Neziri

## **Trajnimi i imamëve dhe mësuesve për edukatë islame në Evropën Juglindore**

Më 21-24.10.2011 në Prishtinë u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare "Trajnimi i imamëve dhe mësuesve për edukatë islame në Evropën Juglindore", e organizuar nga Instituti i Pedagogjisë Fetare Islame (Fakulteti i Filozofisë dhe Pedagogjisë pranë Universitetit të Vjenës) në bashkëpunim me Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë.

Në këtë konferencë morën pjesë 32 referues nga gjithsej 24 shtete.

### **E premte, 21 tetor 2011**

Në ceremoninë e hapjes të pranishmëve iu drejtuan me fjalë përshëndetëse:

- Fahrush Rexhepi, në vend të myftiut Naim ef. Tërnavë, i cili ishte nisur për në haxh
- Mujë Rugova, rektor i Universitetit të Prishtinës
- Johann Brieger, ambasador i Austrisë në Kosovë
- Ednan Aslan, udhëheqës i Institutit të Pedagogjisë Fetare Islame, Fakulteti i Filozofisë dhe Pedagogjisë, Universiteti i Vjenës
- Qazim Qazimi, dekan i Fakultetit të Studimeve Islame në Prishtinë

### ***Seanca e parë***

Në **seancën e parë** që filloi para dite aty kah ora 11.30, nën drejtimin e moderatores Besa Ismaili Ahmeti, pedagoge në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, nga ana e referuesve të pranishëm u mbajtën kumtesat në vijim (secila mesatarisht nga 15 min):

1. ***"Identiteti fetar dhe globalizmi"***, Qazimi Qazimi, dekan i FSI në Prishtinë,
2. ***"Edukimi fetar në Shqipëri – Rasti i Medresesë së Tiranës në mes viteve 1924-1964 dhe nga viti 1991 deri në ditët e sotme"***, Bayram Karçi nga Universiteti Bedër në Tiranë,
3. ***"Edukimi islam në Maqedoni"***, Muhamed Ali nga Fakulteti i Shkencave Islame në Shkup,

4. ***“Statusi i imamit dhe pozita e tij në të kaluarën dhe tani – me fokus në territoret shqiptare”***, Xhabir Hamiti nga Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë.

### ***Seanca e dytë***

Pas namazit të xhumasë u zhvillua **seanca e dytë** me këta referues e kumtesa, nën moderimin e Zoltan Sulok nga Bashkësia e Muslimanëve në Hungari:

5. ***“Statusi i imamëve në Bosnjë dhe Hercegovinë”***, Dr. Mustafa Hasani nga Fakulteti i Shkencave Islame në Sarajevë,
6. ***“Roli dhe rëndësia e xhamisë në bashkësinë islame”***, Dr. Muamer Zukorlić, Myfti i Sanxhakut,
7. ***“Trajnimi kroat për imamë dhe profesorë të edukatës islame në Evropë”***, Dr. Aziz Hasanović, Meshihati i Bashkësisë Islame në Kroaci,
8. ***“Dawah (Thirrja) në shoqërinë botërore me ndryshime të vazhdueshme – sfidat e reja në punën e imamëve”***, Omer Kajoshaj nga Bashkësia islame në Mal të Zi,
9. ***“Trajnimi i imamëve dhe mësuesve fetarë në Bullgari”***, Sefer Hasanov nga Instituti për Studime të Larta islame në Sofje, Bullgari,

Diskutime...

Pauzë...

### ***Seanca e tretë***

Në pasditen e vonshme të së premtes, nën moderimin e Eileen M. Daily nga Universiteti Loyola në Çikago, u referuan kumtesat vijuese:

10. ***“Praktikat për avancimin profesional të imamëve dhe mësuesve të edukatës islame në Austri”***, Vahidin Behluli nga Unioni i Muslimanëve Shqiptarë në Austri,
11. ***“Trajnimi i imamëve dhe shkollimi i lartë në Francë”***, Samim Akgönül nga Universiteti i Strasburgut, Francë,
12. ***“Trajnimi i imamëve në Evropë: sfidat e përgatitjes së një programi të unifikuar, Universiteti i Leidenit si një rast për t’u studiuar”***, Mohammad Ghaly nga Universiteti i Leidenit, Holandë,
13. ***“Edukimi për një profesion të vjetër në një kontekst të ri: Programi i Universitetit “Inholland” për trajnimin e imamëve në Holandë”***, Johan Meuleman nga Universiteti Inholland, Holandë,
14. ***“Trajnimi i imamëve dhe mësuesve të edukatës islame në Zvicër midis nevojës reale vendore dhe frikës së importuar”***, Rejhan Neziri, imam dhe mësues i edukatës islame nga Zvicra,

Diskutime...

**E shtunë, 22 tetor 2011**

***Seanca e katërt***

Nën moderimin e Dr. Ednan Aslan, me fillim nga ora 09.00, u zhvilluan kumtesat e mëposhtme me referuesit:

15. ***“Përgatitja dhe trajnimi i imamëve në Rusi duke marrë si shembull Tataristanin”***, Said Shagaviev nga Universiteti Islam i Rosisë,
16. ***“Modeli evropian i Islamit në Dobruxha”***, George Mircea Botescu nga Universiteti i Bukureshtit,
17. ***“Edukimi islam në shoqëritë moderne është në kushte minoritare”***, Rustam Gafuri, zv. myfti i Ukrainës,
18. ***“Statusi legal i minoritetit musliman turk në Trakinë Perëndimore, Greqi: Situata e tanishme në fe dhe besim dhe aktivitetet e myftiut të Komotinit”***, İbrahim Şerif, myfti i Komotinit, Greqi,
19. ***“Trajnimi i imamëve dhe i mësuesve të edukatës islame në Turqi”***, Şeyma Arslan nga Universiteti i Stambollit,

Diskutime...

Pauzë

***Seanca e pestë***

Nën moderimin e Ali Yurtsever nga Niagara Educational Services (SHBA), u mbajtën kumtesat në vijim:

20. ***“Trajnimi i alimëve muslimanë (imamëve) dhe mësuesve në Mbretërinë e Bashkuar: sfidat dhe e ardhmja”***, Abdullah Şahin nga Qendra për Mendim dhe Praktika Edukative Islame, Angli,
21. ***“Trajnimi i imamëve e mësuesve për edukatën islame në Belgjikë”***, Yacob Mahi nga Universiteti i Strasburgut, Francë,
22. ***“Qendrat për trajnimin e imamëve në Spanjë”***, Juan Ferreiro Galguera nga Universiteti A Coruña, Spanjë,
23. ***“Reflektime rreth rolit të trajnimit të imamëve dhe mësuesve muslimanë për Evropë”***, Jørgen S. Nielsen nga Universiteti i Kopenhagës, Danimarkë.

Diskutime...

Pauzë

### ***Seanca e gjashtë – Prezantimi i studiuesve të rinj***

Moderatore: Zsofia Windisch

24. ***“Raporti ndërmjet imamëve dhe adoleshentëve”***, Kevser Muratović magjistruese në departamentin e Pedagogjisë pranë Universitetit të Vjenës, Austri,
25. ***“Implementimi i standardeve të kualitetit – një mundësi e mirë për avancimin e edukimit islam në Kosovë”***, Ilire Halimi Poniku, magjistruese në Pedagogjinë Fetare Islame, U. i Vjenës,
26. ***“Imamët në shoqëritë perëndimore – pse aftësitë e komunikimit kanë rëndësi po aq sa njohuritë fetare për të ardhmen e imamëve të Kosovës?”***, Jeton Mehmeti, analist politikash pranë Institutit për Studime të Avancuara “Gap”, Prishtinë,
27. ***“Gratë kosovare dhe xhamia”***, Besa Ismaili Ahmeti, FSI në Prishtinë,
28. ***“Nevoja për vlerësimin e trajnimit të imamëve në Pakistan”***, Muhammad Nadeem nga Pakistani

Diskutime...

Vizitë e ekspozitës “Familja Bogujevci/Histori Vizuale” rreth rënies dëshmor të familjes Bogujevci të Podujevës më 28 mars 1999 – Galeria e Arteve E Kosovës në Prishtinë...

**E diel, 23 tetor 2011**

### ***Seanca e shtatë***

Nën moderimin e Abdullah Şahin u mbajtën edhe kumtesat e fundit të kësaj konference:

29. ***“Kompetenca Shpirtërore – një term i ri kyç për kishat protestante në vendet gjermanofolëse”***, Martin Rothgangel nga Universiteti i Vjenës,
30. ***“Formimi i edukatorëve fetarë katolikë në Shtetet e Bashkuara”***, Eileen M. Daily nga Universiteti Loyola i Çikagos, SHBA,
31. ***“Statusi dhe analiza e zhvillimit profesional të imamëve në Pakistan”***, Muhammad Naeem Mohsin nga Universiteti i Pedagogjisë, Lahor,

32. ***“Roli i imamëve (predikuesve fetarë) dhe trajnimi i tyre në Amerikë”***, Ali Yurtsever nga Niagara Educational Services, SHBA.

Diskutime...

Pauzë

Përmbledhje dhe përfundime